



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.36.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË PËR NDIHMË
JURIDIKE FALAS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Maj 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Hysen Boqolli (Udhëheqës Ekipi), dhe Vlora Duraku.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	16
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	19

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryesuesin e Këshillit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë gjithë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 30 shtator 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyra vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).*

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Menaxhmenti i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Politikat dhe procedurat aktuale kanë ofruar funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive. Ne nuk kemi ndonjë çështje me prioritet të lartë për të raportuar. Megjithatë, për sa i përket proceseve të prokurimit, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas duhet të marrë masa dhe veprime shtesë për të forcuar edhe më tej proceset dhe për të ngritur kontrollet.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklarata ka për qëllim t'i ofrojë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

ANJF, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar**).

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013; dhe
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ANJF kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesën Buxhetore dhe rishikimin e buxhetit për vitin 2013;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative (performancës), për vitin 2012;
- Planin e prokurimit me kohë, për vitin 2013;
- Raportimin e obligimeve mujore në MF;
- Planin e rrjedhjes së parasë;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i ANJF-së vërehet se ka gatishmëri për të përmirësuar dobësitë dhe mangësitë e identifikuara nga auditimet e mëhershme. Si rezultat i kësaj ata kanë funksionalizuar dukshëm mekanizmat e kontrollit të brendshëm. Andaj, ne inkurajomë menaxhmentin të vazhdojnë të adresojnë edhe rekomandimet e dala nga ky raport i auditimit.

Përshkrimi

Në raportin e auditimit për PVF-të e vitit 2012, ne kemi dhënë vetëm një rekomandim lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit, përkatësisht lidhur me përgatitjen e kontratave. Rekomandimi i dhënë ishte adresuar nga menaxhmenti (shih Shtojcën II).

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive përveç në fushën e prokurimit. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Menaxhmenti i ANJF-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Politikat dhe procedurat aktuale kanë ofruar funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive.

Megjithatë, si fushë specifike për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm edhe me tutje mbeten procedurat e prokurimit. Si rrjedhojë e kësaj Agjencia për Ndihmë Juridike Falas duhet të marrë masa dhe veprime shtesë për t'i ngritur kontrollet në këtë fushë.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ANJF, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	292,345	312,975	289,564	284,263	274,115
Granti i Qeverisë -Buxheti	292,345	292,345	282,609	284,263	274,115
Donacionet e jashtme	-	20,630	6,955	-	-

Nga tabela më lartë shihet se Buxheti final ishte rritur për 20,630€, në raport me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte si rezultat i pranimit të donacioneve (granteve) të jashtme. Kjo rritje është bërë pas procesit të rishikimit buxhetor.

Gjatë këtij viti, ANJF ka shpenzuar 289,564€ ose rreth 93% të buxhet final. Në raport me vitin 2012, në të cilin kishte shpenzuar 99% të buxhetit final vërehet një rënie për 6%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	292,345	312,975	289,564	284,264	274,115
Pagat dhe Mëditjet	127,455	127,455	123,782	122,585	122,874
Mallrat dhe Shërbimet	142,370	169,500	153,824	148,608	135,891
Shërbimet komunale	22,520	16,020	11,958	13,071	15,350

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për kategorinë mallra dhe shërbime ishte rritur për 27,130€ (20,630€ nga donacionet e UNDP-së dhe 6,500€ nga transferimi nga kategoria e shërbimeve komunale). Megjithatë edhe përpos rritjes së buxhetit final një pjesë e mjeteve kishin mbetur të pashfrytëzuara; dhe
- Në kategorinë e shërbimeve komunale kishte reduktim të buxhetit për 6,500€. Reduktimi i buxhetit ishte bërë me rishikim të buxhetit, pasi është vërejtur se një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve do të mbesin të pashfrytëzuara.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Donacionet e jashtme	-	20,630	20,630	-	-
Totali	-	20,630	20,630	-	-

Siç mund të shihet, gjatë vitit janë shpenzuar rreth 34% e donacioneve të jashtme.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Gjatë vitit 2013, ANJF nuk kishte planifikuar buxhet për kategorinë e investimeve kapitale. Të gjitha kontratat (gjithsej 14) ishin nënshkruar për mallra dhe shërbime. Ne kemi testuar katër (4) nga këto kontrata.

Auditimi ynë ka përfshirë procesin e prokurimit, duke filluar nga inicimi i aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave.

Ne identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja - 1 Mungesë e ftesës për ofertim - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas nenit 36, paragrafi 2 i LPP-së, Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë njëkohësisht, së paku tre (3) operatorëve ekonomik (OE) një kërkesë më shkrim për kuotimin e çmimeve dhe, aq sa është e mundshme, sa më shumë operatorëve ekonomik sa është e nevojshme për të siguruar se konkurrenca efektive për kontratën përkatëse nuk dëmtohet.

ANJF nuk kishte dërguar ftesa më shkrim të OE-të lidhur me procedurat e kuotimit të çmimeve. Kjo është vërejtur në tri kontrata të testuara (Furnizim me derivate, Furnizimi me material higjenik, dhe kontrata e Mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve).

Rreziku Zhvillimi i procedurave të kuotimit të çmimeve duke anashkaluar kërkesat e LPP-së, përkatësisht në mungesë të ftesave me shkrim mund të dëmtojë konkurrencën efektive.

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurojë nivel më të lartë të konkurrencës gjatë zhvillimit të procedurave më kuotime të çmimeve. Në këtë aspekt të dërgohet kërkesa me shkrim OE që ftohen të marrin pjesë.

Çështja - 2 Mos informim i OE-së të pasuksesshëm - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas nenit 54 të LPP-së, Nëse autoriteti kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.

Në kontratat e testuara (Furnizim me derivate dhe Furnizim me material higjienik), vërejtëm se pas kryerjes së vlerësimit nga ana e komisionit të vlerësimit, zyrtari i prokurimit nuk kishte njoftuar OE-të e pasuksesshëm lidhur me dhënien e kontratës.

Rreziku Mos informimi i OE-së të pasuksesshme, rritë rrezikun për mungesë të transparencës, dhe kufizon mundësinë për ushtrimin e ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Rekomandimi 2 Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurojë se ekziston një proces i vazhdueshëm i informimit për OE-të e pasuksesshëm.

Çështja - 3 Pranimi i mallrave pa komisione - Prioritet i mesëm

E gjetura ANJF nuk kishte kontrole të duhura në procesin e pranimi të mallrave dhe shërbimeve. Në 15 pagesa të testuara, ne vërejtëm se ANJF nuk kishte formuar komisione për pranimin e tyre. Të gjitha mallrat ishin pranuar nga një person i vetëm.

Rreziku Pranimi i mallrave dhe shërbimeve pa komisione, i ekspozohet rrezikut që mallrat dhe shërbimet e pranuar, të jenë me sasi dhe cilësi më të ulët në raport me sasinë dhe cilësinë e kontraktuar.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Këshillit duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e pranimi të mallrave dhe shërbimeve, duke formuar komisione për pranimin e tyre.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar pagesat për udhëtime jashtë vendit, shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës si dhe shpenzimet e qirasë. Gjatë testeve të bëra në nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi për tu raportuar.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve për vitin 2013 ishin në vlerë prej 123,782€.

Ne testuam procedurat e rekrutimit, mirëmbajtjen e dosjeve të personelit, përfshirjen e të punësuarve të ri në listën e pagave dhe procesimin e pagave për pagesë.

Ne konstatojmë se sistemi i kontrolleve në këtë sektor funksionon mirë. Menaxhmenti i ANJF-së kishte ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat për paga dhe mëditje të dokumentohen dhe procesohen në harmoni me kërkesat ligjore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Pasuritë

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK) lista e pasurive të ANJF-së është 44,836€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ është 15,364€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi verifikuar nëse ekziston fizikisht pasuria e evidentuar në regjistrat e pasurisë.

Ne konstatojmë se ANJF, kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me praktikën e mira menaxheriale dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Zyrtari i pasurive ka bërë azhurnimin e vazhdueshëm të pasurisë, andaj posedon një regjister të plotë dhe të saktë lidhur me pasurinë që disponon. Në fund të vitit ishte kryer edhe inventarizimi i pasurisë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, ANJF nuk i plotëson kriteret për të themeluar këtë njësi.

Meqenëse, ANJF është institucion me buxhet të vogël auditimet e brendshme nuk bëhen për çdo vit. Auditimi i fundit ishte bërë në fund të vitit 2011 dhe ka përfshirë menaxhimin e shpenzimeve si dhe dosjet e personelit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për

Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm; dhe
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen.
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.4.1. Prokurimi	Menaxhmenti i ANJF-së, duhet të sigurojë se kushtet e përcaktuara në dosje të tenderit do të jenë bazë për përgatitjen e kontratave, që do të thotë se dispozitat e përcaktuara të kontratës duhet të inkorporojnë të gjitha kërkesat e detyrueshme të specifikacionit teknik.	I adresuar plotësisht		